



Mbikëqyrja elektronike për mbrojtje nga dhuna, kanosjet dhe ndjekjet

Për të qenë mbrojtur më mirë nga dhuna, kanosjet ose ndjekjet nga ana e një personi të caktuar rrezikues, pranë gjykatës civile ju mund të parashtroni kërkesë sipas nenit 28b ZGB (Kodi civil), që ky person të ndalohej për një kohë të caktuar të ju afrohet dhe/ose të ju kontaktojë. Veç kësaj gjëje ju mund të parashtroni kërkesë sipas nenit 28c ZGB pranë gjykatës civile, që për mbikëqyrjen e kësaj ndalese ky person të mbajë një aparat elektronik përgjimi. Personi i mbikëqyrë mund të obligohet, që të bartë një pjesë të kostove të kësaj mbikëqyrjeje.¹

Si funksionon mbikëqyrja elektronike?

Personit, i cili duhet mbikëqyrë, i vihet një aparat përgjues në nyjën e këmbës. Ky aparat përgjues lajmëron nëpërmjet GPS-së, seku gjindet personi në çfarë momenti. Aparati përgjues lajmëron gjithashtu, nëse ai hiqet ose manipulohet. Në intervale të rregullta (jo në kohën aktuale) këqyret, nëse personi e ka shkelur ndalesën («mbikëqyrja» e ashtuquajtur «pasive»). Shkeljet shihen vetëm pas kryerjes së tyre. Kontaktimet e ndaluara përmes rrugëve jo fizike (përmes celularit, Whatsapp-it, telefonit, e-mail-it, letrave) nuk mund të vihen re.

Si më mbron mua mbikëqyrja elektronike?

Mbikëqyrja elektronike nuk garanton, që personi i mbikëqyrë ta respektojë ndalesën e kontaktimit dhe të afrimit. Megjithatë nëse personi nuk e respekton ndalesën, atëherë autoritetet e shohin këtë fakt (pas kryerjes së shkeljeve). Kështu mund të vërtetohet me provë, që një shkelje ka ndodhur dhe ku ka ndodhur. Synohet, që kjo masë të ndihmojë, që personi rrezikues ta respektojë ndalesën e kontaktimit dhe të afrimit.

Çfarë ndodh në rastin e një shkeljeje?

Një shkelje shihet vetëm pas kryerjes së saj («mbikëqyrja» e ashtuquajtur «pasive»). Në momentin, kur autoritetet e shohin shkeljen, personi rrezikues në shumicën e rasteve tashme është larguar nga vendi i ndaluar. Prandaj policia *nuk* informohet, sepse shkelja tashme është kryer dhe nuk mund të parandalohet më nga ana e policisë. Kur autoritetet e shohin shkeljen në sistemin mbikëqyrës, atëherë ato ia lajmërojnë shkeljen prokurorisë dhe gjykatës civile brenda pak ditësh pune. Prokuroria shpall ndaj personit të mbikëqyrë një gjobë. Veç kësaj gjykata civile sipas kërkesës suaj mund ta zgjasë mbikëqyrjen elektronike, nëse ekzistojnë parakushtet për këtë veprim.

A informohem unë, nëse kryhet një shkelje?

Ju lajmëroheni për shkeljet brenda pak ditësh pune (kopja e lajmërimit për prokurorinë). Nëse nuk dëshironi të lajmëroheni për shkeljet, atëherë ju mund ta deklaroni para gjykatës civile.

Çfarë mund të bëj, nëse nuk ndihem i/e sigurt?

Nëse jeni në shtrëngesë, atëherë në çdo kohë thirrni policinë me numrin emergjent 117.

Kujt mund t'i drejtohem, nëse kërkoj përkrahje?

Në Kantonin Basel-Stadt (Bazel qytet) keni në dispozicion disa oferta të ndryshme përkrahjeje. Në kartën emergjente i gjeni të gjitha zyrat profesionale, të cilave mund t'u drejtoheni.

- Karta emergjente edhe nën:
- <https://www.bs.ch/themen/sicherheit-und-demokratie/gewalt/haeusliche-gewalt/infomaterial-deutsch-und-fremdsprachen>
- Ndihma e viktimave e të dy Bazel-ve këshillon në pyetje sociale, ligjore, psikologjike, mjekësore, në pyetje të fushës së sigurimeve dhe të financave: Tel. 061 205 09 10, www.opferhilfe-beiderbasel.ch

¹ Bazat ligjore niveli federal: ZGB nenet 28b dhe 28c: https://www.fedlex.admin.ch/eli/cc/24/233_245_233/de (gjendja janar 2022)
Bazat ligjore niveli kantonal: Rregullorja mbi mbikëqyrjen elektronike për mbrojtjen e personave të cenuar nga dhuna (SG 212.191): https://www.gesetzessammlung.bs.ch/app/de/texts_of_law/212.191 (gjendja janar 2022).